



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 896/1 prot.

Tiranë më 04.5.2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1968/8 prot., datë 27.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 896 prot., datë 29.04.2022, përmes së cilës ridërgohet për bashkërendim projektvendimi “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, rregullat për ndërvëprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe nivelin e aksesimit në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, por me banim të përhershëm në shtetin Shqiptar”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatojmë se, sugjerimet e bëra nga ana e Zyrës së Komisionerit përmes shkresës nr. 763/1 prot., datë 14.04.2022, janë reflektuar në përmbajtje të projektvendimit të sipërcituar, për rrjedhojë ky projektvendim vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

